



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL BERAT
TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ Prot.

Berat, më ____ . ____ . 2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Sherbimi I Lavanterise - Marrëveshje Kuadër me një operator te vetem ekonomik fitues per secilin lot, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 12 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Sherbime Lavanderie 42716000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit*i marrëveshjes kuadër (në total për të gjitha lotet 5,827,140 (pesemilioneteteqindenjeteeshatemijeenejqindedyzete) lekë pa TVSH

Argumentimi i fondit limit: Eshte perlogaritur per periudhen 12-mujore nga Komisioni I Argumentimit te Fondit limit me shkresen Nr.1404 Prot., datë 04.04.2023 per proceduren me objekt: “Sherbimi I Lavanterise” me Fondin limit*i marrëveshjes kuadër 5,827,140 (pesemilioneteteqindenjeteeshatemijeenejqindedyzete) lekë pa TVSH, bazuar ne nenet 34,35 te ligjit Nr. 162/2020 dhe nenin 76 pika c e VKM_RPP_285_19.05.2021.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit dhe kërkesat e pikës 1 (gërmat a / b) të kriterëve të veçanta të kualifikimit janë parashikuar pa ndryshime, sipas formatit të dokumenteve standarde të tenderit të publikuara nga APP, dhe vendosja e tyre është bazuar në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën **116,542.8** (njqindëgjashtembedhjetemijepeseqindedyzeteedypiketete).

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

c. Formularin e Ofertes sipas shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e parashikuar se: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor),

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë e kriterëve plotësohet me kriteret e përgjithshme të pranimit/ kualifikimit të plotësuar më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

3.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Shënim:* Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilin ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10.

Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejme të percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; në piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku percaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku percaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

3.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

3.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontratën e shërbimit, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim:* Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilën ofertohet, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10.

Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që furnizimet e mallrave të mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvajave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që furnizimet e mallrave të mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

3.3.2. Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme, si më poshtë:

ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit cilësisë” sipas konformitetit me standartet europiane ose ekuivalente lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit ambjentit” sipas konformitetit me standartet europiane ose ekuivalente lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) sipas konformitetit me standartet europiane ose ekuivalente *lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*

SSH EN 14065:2016/UNI ENI 14065(certifikate qe verteton sistemin e kontrollit te Biokontaminimit) – sipas konformitetit me standartet europiane ose ekuivalente *lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.*

Shenim: Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, kriteri i siperpermendur plotësohet nga te gjithë operatorët ekonomik se bashku.

Argumentimi: Kërkesa emesiperme bazohet nenenin 77, pika 1/a),nenin 79 te ligjit Nr. 162 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, nenin 44 teVKM Nr.285, date 19.05.2021 "Per miratirnin erregullave teprokurimit publik", eshte kerkuar kjo certifikate meqellim qeoperatorët ekonomikeqedotezbatojne kontraten tejene te certifikuar ne sistemin e kontrollit te Biokontaminimit. Certifikata duhet te jete e leshuar nga nje organ I vleresimit te konformitetit, I akredituar nga organizma Kombetar I akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Nisur nga Rendesia, volume I kontrates, rendesia e AK (Autoriteti Kontraktor) te perfshire ne kete procedure eshte e rendesishme me qellim realizimin me sukses te kesaj procedure qe operatori pjesmarres te provojne se ka nje system te tille, pra te demostrojne aftesine e tij per te ofruar vazhdimisht produkte qe plotesojne kerkesat e AK-se dhe kerkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative nepermjet zbatimit efektiv te sistemit, duke perfshire proceset per permiresimin e vazhdueshem te sistemit ndaj klientit pra AK-se. Ky standart European pershkruan nje qasje te menaxhimit te rrezikut, te quajtur analiza e rrezikut dhe kontrollit te Biokontaminimit (RABC), I projektuar per te lejuar pastrimin e produkteve te vazhdueshme per te siguruar cilesine mikrobiologjike te indeve te trajtuara ne Lavanteri, pra lidhet ngushtesisht me objektin e prokurimit, pasi eshte pjesa kryesore e objektit te prokurimit eshte larja e materialeve te kontaminuara te cilat pasi te lahen do te perdoren per shtreterit e pacienteve te semure apo personelit mjekesor, si dhe per sallat e operacioneve ku cdo gje duhet te jete sa me sterile dhe e paster.

Argumentim: SSH EN 14065:2016 eshte certifikate e cila shpreh rendesine e Impaktit ne mjedis, filtrimin e sistemit te ujit, ujerat qe shkarkohen nga lavatricet kalojne ne filtrim.

Çertifikatat duhet te jene te vlefshme dhe te leshuara nga nje organ I vleresimit te konformitetit, I akredituar nga organizmi kombetar I akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga RSH.

3.3.3. Operatori ekonomik duhet te disponoje ambjentin ku ushtron veprimtarine e sherbimit te lavanderise per te cilin duhet te paraqese dokumentacionin e meposhtem:

a-Dokumentacion qe verteton pronesine ose huaperdorjen ose qiramarrjen si me poshte:

-Dokument qe verteton pronesine:

Certifikate pronesie te leshuar nga institucioni i autorizuar, ose kontrate shitblerje ose kontrate dhurimi ose cdo dokument me ane te cilit fitohet e drejta e pronesise sipas kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

-Dokument qe verteton huaperdorjen :

Kontrate noteriale huaje.

-Dokument qe verteton marrjen me qira:

Kontrate noteriale qiraje.

b- Akt miratimi higjeno-sanitar per kete ambjent leshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.

c- Te shoqeruar me akt-teknik leshuar nga PMNZH per sa i takon masave mbrojtese ndaj zjarrit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjen teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ambjenti ku ushtrohet aktiviteti eshte nje nga paisjet baze per realizimin me sukses te ketij sherbimi.

3.3.4. Operatori ekonomik duhet te jete i paisur me leje Mjedisore e tipit B per veprimtarine e leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) per aktivitetin “pastrim kimik/ ose lavanteri”, per vendin ku ushtron kete aktivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne mbështetje te ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011”Per lejet e mjedisit” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10081, date 23.02.2009 ”Per licensat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar, te ndryshuar dhe VKM Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licensat dhe lejet, qe trajtohen nga/apo nepermjet QKB dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa” e ndryshuar.

3.3.5.Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar mesatarisht 9 (nente) punonjes te vertetuar me:

-Vertetim nga sistemi e albania per numrin e punonjesve te siguruar te shoqeruar me listepagesat (formulet E-sig 025 a) sipas sistemit E-Albania per gjashte muajt e fundit.

Nga punonjesit 8 (tete) duhet te jene punetore ne lavanteri dhe 1 (nje) duhet te jete shofer

-Punonjesit te kene kontrata te vlefshme pune ne momentin e hapjes se procedures kurse shoferi te kete kontrate pune te vlefshme dhe Leje drejtimi Automjeti.

Operatori Ekonomik duhet ti deklaroje me te dhenat si meposhte:

Nr.	Emer Mbiemer	Profesioni	Kodi i deklarimit ne listpagese E-sig 0.25	Data e fillimit te punes
-----	--------------	------------	--	--------------------------

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nga punonjesit 8 (tete) duhet te jene punetore ne lavanteri (3 punonjes ne proceset e larjes sipas materialeve perkatesisht, 2 punonjes ne Hekurosje, 1 punonjes ne tharje, 1 punonjes ne paketim, 1 punonjes transport i brendshem me karrelat transportues dhe 1 (nje) duhet te jete shofer.

3.3.6. Operatori Ekonomik duhet te disponoje makinerite dhe paisjet si me poshte:

- Makine larese profesionale me kapacitet nga 50-100 kg cope 2 (dy).
- Makine larese kimik profesionale perfshire dhe per jastek me kapacitet nga 20-50 kg cope 1 (nje).
- Makine larese me dy porta per larjen e te butave kirurgjikale me kapacitet nga 10-50 kg cope 1(nje).
- Makine tharese profesionale me kapacitet nga 50 deri ne 100 kg cope 2 (dy).
- Makine per hekurosje me rul profesional me gjeresi mundesi hekurosese 1.6 -2.6 m cope 1 (nje).
- Makine paketimi profesionale per material te bute cope 1(nje).
- Karrela levizes metalike ose plastike cope 6 (gjashte).
- Peshore elektronike mbi 50 kg cope (nje).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjen teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Makinerite e paisjet e siperpermendura jane kerkuar ne raport me sasine ditore te te butave, llojin e te butave qe kerkohen te lahen nga AK.

3.3.7. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin për pajisjet dhe instrumentat e mesipërme që vërtetojnë se këto pajisje janë në pronesi ose me qera ose me huapërdorje të cilat të vërtetohen me fatura blerje/dokument zhdoganimi ose kontrata qiraje ose kontrate huapërdorje.

Autoriteti Kontraktor pas publikimit të njoftimit fitues do të verifikojë pranë ambjentëve të Operatorit Ekonomik disponimin e pajisjeve të sipërkerkuara.

Ky verifikim do të evidentohet nëpërmjet mbajtjes së një proces-verbali në selinë e OE të nënshkruar nga Operatori Ekonomik dhe KVO.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Shenim: *Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

3.3.8. Operatori Ekonomik duhet të deklarojë materialet e pastrimit që do të përdoren për kryerjen e shërbimit të largës se të butave të porositura nga Spitali Rajonal Berat me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emertimi i materialit që do të lahet	Vendi i Origjines se materialit të pastrimit	Certifikime të leshuara nga një organ i akredituar CE/ose ekuivalent
1	Material i kontaminuar		
2	Material me rrezik mikrobiologjik		
3	Veshjet e personelit shëndetësor (përparëse mjeku, uniforma infermieresh e sanitaresh		
4	Kellef dysheku i gomuar		
5	Material i pisët, ndotur nga pacientet		

Për çdo produkt duhet të paraqitet Certifikata.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjen teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Emertimi i materialeve është bërë bazuar në përdorimin e llojeve të të butave nga shërbimet/pavionet/personeli mjekësor dhe infermieror.

3.3.9. Operatori ekonomik duhet të disponojë të pakten1(nje) mjet transporti të pershtatshëm për transportin e materialeve të buta në pronesi ose të marre me qera ose huapërdorje të shoqëruar me dokumentacion përkatës (leje qarkullimi, certifikate të kontrollit teknik dhe police për sigurimin e detyrueshëm të mjetit).

-Në rastin e pronesisë duhet të paraqitet certifikata e pronesisë e leshuar nga institucioni përkatës.

-Në rastin e marrjes me qira duhet të paraqesë kontratën noteriale të qeramarrjes.

-Në rastin e huamarrjes të paraqesë kontratën noteriale të huamarrjes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjen teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Shenim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj: Larje Materialelesh te Buta Spitalore

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia e pritshme	Çmimi	vlera
	Sherbimi I Lavanterise	kg	35,316		

A. Parametrat teknik

Shoqëritë pjesëmarrëse në tender për shërbim larje teshash, gjatë zbatimit të kontratës në rast shpallje fitues duhet të zbatojnë këto specifikime.

1. Teshat që do të lahen janë çarçafë, kullëf, peshqira, mbulesa, perde, batanie, dyshek, bizhama, perparese, peceta, kostume infermieresh, grykse mjeku etj.

2. Teshat të pastrohen mirë me detergjent me aromë të këndëshme, zbutes teshash dhe të mos kenë njolla.
3. Pas larjes teshat do të hekurosen dhe paketohen në menyre te pershtateshme.
4. Marrja dhe dorëzimi i teshave nga Spitali Rajonal Berat do të bëhet me mjetet e kontraktuesit.
5. Grafiku i larjes i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor është i detyrueshëm për kontraktuesin me lidhjen e kontratës.
6. Teshat do të merren dhe dorëzohen, duke mbajtur dokumentacionin përkatës.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike jane hartuar nga Sektori i Hotelerise te miratuara me shkresen me Nr. 680 Prot. date 14.02.2023.

NJESIA E PROKURIMIT

Armelin Çili

Aida Doko

Elona Dundo

MIRATOI

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ANILA KALA